

**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**KOLEGJI ISPE**



## **RREGULLORE E KOLEGJIT ISPE**

**E ZYRËS PËR ZHVILLIMIN E KARRIERËS**

**Miratuar më 24.10.2014 me Vendim  
të Këshillit të Kolegjit**

**PRISHTINË 2014**

#### Neni 4

1. Zyrën për Zhvillimin e Karrierës e udhëheq një zyrtar i stafit administrativ të Kolegjit ISPE.
2. Zyra për Zhvillimin e Karrierës për punën e saj i përgjigjet Sekretarit të Kolegjit ISPE.

### KOMPETENCAT E DREJTUESIT TËZYRËS PËR ZHVILLIMIN E KARRIERËS

#### Neni 5

Drejtuesi i Zyrës për Zhvillimin e Karrierës ka për detyrë:

- Informojë dhe të mbështesë të rinjtë;
- Promovojë një kulturë që mbron interesat e të rinjve, duke përfshirë edhe vetë të rinjtë;
- Hartojë një politike organizative për mbrojtjen e të rinjve;
- Krijojë një kulturë dhe sisteme që nxisin barazinë dhe vlerësojnë diversitetin;
- Sigurojë që të respektohen kërkesat ligjore, rregulloret dhe etika në punën me të rinjtë;
- Ushtrijë ndikim dhe të mbështesë hartimin e strategjive për punën me të rinjtë, dhe punësimin rinor;
- Krijojë lidhje me komunitetin vendas dhe aktorët e rëndësishëm për punësimin rinor;
- Vlerësojë dhe caktojë prioritetet për aktivitetet me të rinjtë;
- Identifikojë dhe sigurojë burime për punën me të rinjtë, duke shfrytëzuar të gjitha mundësitë ekzistuese apo të reja;
- Punojë me të rinjtë për të mbrojtur interesat e tyre duke i konsideruar si partnerë të rëndësishëm aktivë;
- Komunikojë në mënyrë efikase dhe të krijojë raport të qëndrueshëm dhe produktiv me të rinjtë;
- Planifikojë dhe udhëheqë punën në grup me të rinjtë;
- Sigurojë udhëheqje në procesin e ndryshimeve;
- Punojë me të rinjtë për të gjetur dhe menaxhuar burimet për aktivitete me të rinjtë;
- Ndhimojë të rinjtë të shqyrtojnë dhe përcaktojnë vlerat dhe bindjet e tyre;
- Ndhimojë të rinjtë t'i kuptojnë dhe t'i shprehin synimet e tyre;
- Ndhimojnë të rinjtë të menaxhojnë burimet dhe zhvillimi profesional vetjak;
- Nxisë të rinjtë të marrin pjesë në hartimin e aktiviteteve;
- Krijojë kushte të rinjve për t'u informuar dhe për të marrë vendime;
- Trajtojë çështje që kanë të bëjnë me shëndetin dhe mirëqenien e të rinjve;
- Angazhojë, motivojë dhe mbështesë vullnetarët;
- Monitorojë dhe vlerësojë cilësinë e aktiviteteve me të rinjtë;
- Aftësojë të rinjtë për të prezantuar veten dhe grupin ku bëjnë pjesë;
- Dhe mbi të gjitha të kryhet punë me profesionalizëm.

## QËLLIMET DHE MISIONI I ZYRËS PËR ZHVILLIMIN E KARRIERËS

### Neni 6

Zyra për Zhvillimin e Karrierës ka për qëllim të identifikojë mundësitë për karrierë, të këshillojë të rinjtë për mundësitë e tyre për punësim dhe karrierë, për zhvillim akademik pasuniversitar, të krijojë kontakte dhe rrjet kontaktesh për t'i vënë ato në funksion të të rinjve për sa i përket:

#### 1. Tregut të punës

Ofrimi i informatave në lidhje me:

- Sektorët më premtues për punësim në tregun e punës;
- Tendencat e tregut të punës;
- Perspektivat e tregut të punës;

#### 2. Mundësitë për vetëpunësim

Ofrimi i informatave në lidhje me:

- Hulimtimine tregut, raporti kërkesë-ofertë;
- Investimet dhe risku i tyre;
- Sfidat e tregut;
- Aftësitë menaxheriale, nismat, udhëheqjen, vendosmërinë
- Krahasimi dhe shqyrtimi i opsioneve në dispozicion;
- Marrja e një vendimi.

#### 3. Zhvillim akademik pasuniversitar

Ofrimi i informatave në lidhje me:

- Mundësitë e studimeve pasuniversitare, programet që janë në dispozicion dhe në trend me kërkesat e tregut;
- Kërkimet dhe avancimet akademike, planet e veprimit;
- Profesionistë të fushave përkatëse të interesit, etj.

#### 4. Aktivitetet vullnetare

Ofrimi i informatave në lidhje me:

- Sektorin publik;
- Sektorin privat;
- OJQ dhe organizma të tjerë që zhvillojnë veprimtari në ndihmë të komunitetit për të fituar eksperiencë pune, ngritje profesionale, dhe zhvillojë aftësitë për punë.

#### 5. Krijimin e rrjetit të kontakteve

Ofrimi i udhëzimeve në lidhje me:

- Krijimin dhe ruajtjen e kontakteve me shokët, kolegët, punëdhënësit, profesorët dhe profesionistë të tjerë.
- Përdorimi efektiv të kontakteve, mjeteve dhe strategjive për kërkimin e punës dhe suksesin në tregun e punës;

Mbështetur në Ligjin Nr. 04/L-037, datë 24.10.2014 "Për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës" dhe Statutin e Kolegjit ISPE, Këshilli i Kolegjit ISPE miraton këtë rregullore:

## **RREGULLORE**

### **E ZYRËS PËR ZHVILLIMIN E KARRIERËS**

#### **Neni 1**

Kjo Rregullore synon rregullimin e veprimtarisë së Zyrës për Zhvillimin e Karrierës të Kolegjit ISPE, mënyrën e organizimit, qëllimet dhe misionin e kësaj zyre.

#### **Neni 2**

1. Zyra për Zhvillimin e Karrierës e ushtron aktivitetin e saj në përputhshmëri të plotë me qëllimet dhe vizionin e Kolegjit ISPE.
2. Zyra për Zhvillimin e Karrierës në ushtrimin e aktiviteteve, detyrave, të drejtave dhe përgjegjësi të saj të parapara me këtë rregullore, zbaton Statutin, Rregulloret dhe aktet e tjera normative të Kolegjit ISPE.

#### **Neni 3**

Misioni i Zyrës për Zhvillimin e Karrierës është:

1. Ofrimi i informatave, udhëzimeve, motivimit dhe ndihmës konkretetë rinjve për të zhvilluar dhe shprehur aftësitë e tyre individuale dhe për të qenë të denjë për të aplikuar për trajnime, internshipe, praktika pune, punësimeetj.
2. Përgatitja e të rinjve me fleksibilitetin dhe përshtatshmërinë e duhur dhe orientimi i tyre për tu njohur me specifikat dhe karakteristikat e veçanta të tregut të punës, kompanive të ndryshme të sektorit publik dhe privat, ndjenjën e përgjegjesisë në punë, sfidat dhe aftësitë për përballimin e tyre, rrugët për të gjetur suksesin dhe për të pasur një zhvillim të qëndrueshëm të karrierës.
3. Njohja dhe kultivimi tek të rinjtë me parimet dhe rëndësinëe kulturës, vlerave dhe përgatitjes profesionale, etikës, kulturës në punë, mirësjelljes dhe punës në grup si çelësi i suksesit profesional dhe zhvillimit në karrierë.

- Mbledhja e informatave, përgatitja e dokumentacionit, shfrytëzimi i kontakteve, mjeteve dhe përparësive të tjera për të pasur përparësi dhe sukses për intervista pune.
6. Zhvillimin profesional dhe aktivitetet trajnuese
- Ofrimi i informatave në lidhje me:
- Ndjekjen e seminareve, panairove, workshopeve, konferencave shkencore dhe aktiviteteve të ndryshme për t'u informuar dhe për të marrë këshillat për shfrytëzimin e teknikave, mjeteve dhe kontakteve për zhvillim në karrierë;
  - Ndjekjen e intershipeve/praktikave për të fituar përvojë pune, krijuar kontakte të reja etj.
7. Krijimin e aftësive të dëshirueshme për punë të caktuara siç janë:
- Përshtatshmëri dhe fleksibilitet;
  - Aftësi analitike;
  - Aftësi komunikuese dhe krijuese;
  - Aftësi dhe shkathtësi në përdorimin e kompjuterit;
  - Aftësi në vendimmarrje;
  - Ndershmëri;
  - Aftësi drejtuese, organizative dhe menaxheriale;
  - Aftësi për të negociuar;
  - Pjesëmarrje në projekte dhe detyra të ndryshme;
  - Sjellje dhe qëndrim pozitiv;
  - Aftësi për tu përshtatur në situata të ndryshme dhe në zgjidhjen e problemeve;
  - Ndjenjë përgjegjësie;
  - Etikë në punë;
  - Punë në ekip etj.
8. Përgatitjen dhe përshtatjen e dokumentacionit sipas qëllimit të caktuar
- Ofrimi i informatave në lidhje me:
- Përdorimin me zgjuarsi të CV-së, ku të nxirren në dukje dhe të promovohen aftësitë, prirjet dhe interesat tuaja në mënyrë që të manifestohet potenciali i të rinjve në mënyrë bindëse dhe konkrete;
  - Intervistën për punë, teknikat e përgatitjes për intervistë, analizimi i kërkesave dhe përshkrimit tëpunës për të cilën zhvillohet intervista, të mësuarit dhe marrjes së informatave etj.
  - Letrën e motivimit, teknikat e përgatitjes së saj, etj.

## Neni 7

1. Zyra për Zhvillimin e Karrierës krijon, sistemon dhe arkivon dokumentacionin e saj në lidhje me aktivitetin që kryen.
2. Zyra për Zhvillimin e Karrierës krijon dhe mirëmban librat e karrierës dhe të dhënat statistikore vjetore në lidhje me suksesin akademik dhe në tregun e punës të të rinjve të cilët kanë kryer studime në Kolegjin ISPE.

### **Neni 8**

Për zhvillimin e aktivitetit të saj Zyra për Zhvillimin e Karrierës qëndron në kontakt të ngushtë me OSE (Organizatën e Studentëve Evropian) të Kolegjit ISPE si dhe me institucionet e ndryshme të sektorit publik dhe privat.

### **Neni 9**

Kjo rregullore hyn në fuqi nëdatën e miratimit.

**Prishtinë, 24.10.2014**

**Kryetar i Këshillit të Kolegjit ISPE**

Gjeneral Karl Heinz Lather



---